



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr.77/10

Prishtinë, më 30.03.2010, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**  
**I Mbledhjes së Komisionit për Buxhet dhe Financa**

Në mbledhje morën pjesë: Gani Koci, Naser Osmani, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Haki Shatri, Armend Zemaj, Hajdin Abazi, Besa Gaxheri, Suzana Novobërdaliu dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Myrvete Pantina dhe Mufera Sinik.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Mecini (Drejtor i Administratës) dhe Mentor Borovci nga AKK, Naile Krasniqi nga KPM, Teki Shala dhe Ramadan Islami nga GTZ monitorues nga Zyra e presidentit, OSBE, NDI, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Natasha Prica Tisma, Vilson Ukaj dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

**Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më datë 24.03.2010;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit nr. 03/3316/Ra-02 vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2009,**  
**I ftuar: Daut Demaku, Nënkyetar i Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit nr. 03/3316/Ra-02 vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2009,**  
**I ftuar: Hasan Preteni, Drejtor i AKK;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare me raportin me amendamente të komisionit funksional - Komisioni për Punë të Jashtme, me amendamente;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për Gazetën Zyrtare me raportin me amendamente të komisionit funksional -Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;**

7. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar;**
8. **Informatë në lidhje me propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndryshimin e tabelave buxhetore 3.2 dhe 4.2 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010;**
9. **Të ndryshme.**
- 9.1. **Plotësimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për Financimin e Subjekteve Politike në Kosovë.**

**Kryesuesi** paraprakisht shprehu keqardhjen që përfaqësuesit e agjencioneve po detyrohen t'iu përgjigjen ftesës për të raportuar në dy komisione për të njëjtën çështje dhe kërkoi që komisioni për Rregulloren e punës së Kuvendit dhe Kryesia e Kuvendit të definojnë sa më shpejtë mandatin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Mbikëqyerjen e Financave Publike. Sipas tij KMFP duhet shqyrtojë raportet e audituara dhe të performancës dhe me iniciativën e vet, të kërkojë nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm raporte të veçanta që kanë të bëjnë me menaxhimin e parasë publike. Ndërkaq KBF shqyrton raportet periodike dhe vjetore financiare.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

### **2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 24.03.2010**

**Kryesuesi** konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më datë 24.03.2010, pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2009**

**Kryesuesi** shkurtimisht lexoi dispozitat e ligjit që obligon KPM-në të raportojë në Kuvend dhe bëri një përmbledhje të shkurtër të raportit financiar.

**Naile Krasniqi** shkurtimisht prezantoi raportin financiar, i cili është realizuar prej 97 %. Në raport janë prezantuar edhe të hyrat nga licencat që ka mbledhur KPM-ja nga operatorët, të cilat janë tejkaluara në raport me ato të planifikuara. Gjithashtu janë prezantuar edhe të hyrat e realizuara nga shqiptimi i sanksioneve, për ata që nuk kanë respektuar ligjin.

**Kryesuesi** pasi që jeni autoritet i vetëm i monitorimit të mediave, kërkoi që të sigurojë një raport Komisionit nga monitorimi i bërë me medimeve publike lidhur me kohën dhe të hyrat që kanë realizuara nga këto medime nga reklamat. Pasi që kemi bërë një zgjidhje të përkohshme për financimin e RTK-së, dhe ajo kohë po kalon dhe duhet gjetur një zgjidhje afatgjate, është e nevojshme të kemi një pasqyrë të qartë për të hyrave që realizon RTK nga reklamat, nga ajo pjesa që vetëfinancohet.

**Armend Zemaj** vlerësoi raportin të mirë, i cili përmbush kriteret financiare për raportim. Më pas pyeti qfarë është politika juaj zhvillimore ndaj medieve dhe operatorëve të ndryshëm, a bëni klasifikim të taksave dhe cilat janë favoret që keni krijuara për zhvillimin aktual të mediave?

**Haki Shatri** theksoi se përkrah raportin dhe punën e KPM-së. Njoftoi se në Komisionin për Mbikëqyerjen e Financave Publike, sot e kemi pasur në rend ditë kërkesën drejtuar Zyrës së Auditorit për auditimin e RTK-së, dhe për fat keq një pjesë e deputetëve që janë këtu, e kanë sabotuar mbledhjen dhe ajo nuk ka mundur të kalojë.

**Kryesuesi** duke iu referuar parafolësit për kërkesën për auditim të RTK-së, thekoi se një kërkesë e këtillë është bërë më herët nga ky komision, para se të themelohej KMFP.

**Naser Osmani** pyeti cilat janë masat ndaj medimeve që nuk kanë respektuar normat e ligjit për zgjedhjet gjatë prezantimit të subjekteve politike, pasi nga raporti shifet se kemi ankesa për mosprezantim të drejtë ?

**Naile Krasniqi** duke iu përgjigjur pyetjes për lirimin taksave, njoftoi se klasifikimi i taksave është ndarë në kategori. Televizionet dhe radiot nacionale janë më të ngarkuara për dallim prej atyre lokale që kanë frekuencë më të dobët. Nivelet e taksave janë kushtëzuara edhe për nga niveli ekonomik i mediave si dhe aplikimi i zbritjeve duke pasur parasysh përmbajtjet programore, pastaj subjektet me të hyra vetanake dhe subjektet minoritare. Operatorët kabllorë janë të ngarkuar me taksa më të larta. Pasi që 31 marsi është afati i fundit për raportim të mediave, do të bëjmë një analizë më të detale për zhvillimin ekonomik të tyre dhe do të rishikohen vendimet që kanë të bëjnë me rritjen apo uljen me taksa. Sa i përket gjobave janë të përcaktuara me ligj dhe ato përcaktohen në proporcion me natyrën e shkeljeve ligjore. Kemi mundësuar pagesën e gjobave me pjesë, për vlerësimin të arsyeshmërisë dhe gjendjes faktike nga kërkuesit. Në pyetjen për masat ndaj medimeve që nuk kanë respektuar normat e ligjit për zgjedhjet gjatë prezantimit të subjekteve politike, përgjithësisht kanë respektuar ligjin, dhe se ka pasur dallime në minutazhen e prezantimit të disa partive, duke iu dhënë përparësi partive më të mëdha. Edhe pse përqindja ka ndryshuar, mediat nuk kanë bërë raportimet të njëanshme. Kemi shqyrtuar të gjitha ankesat dhe kemi dhënë përgjigjen ndaj tyre, me vërejtjet konkrete që është edhe një llojë mase sanksionuese.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **REKOMANDIM**

- I.** I rekomandohet Kuvendit të Kosovës që në senacë plenare, të miratojë Raportin financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2009.
- II.** Komisioni i Pavarur për Media duhet t'i paraqes Komisionit për Buxhet dhe Financa një raport lidhur me monitorimin e medimeve publike, sa i përket emitimit të reklamave dhe të hyrave të realizuara nga këto reklama.

### **4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2009**

**Besa Gaxherri** theksoi se nuk ka vërejte për pjesën buxhetore të raportit, ndërsa për nga përmbajtja shifet se niveli i korrupsionit është në ngritje dhe për të gjitha këto çështje do të diskutohen në Kuvend, ku edhe do të diskutohet raporti.

**Armend Zemaj** kërkoi sqarime më të shumta për shpenzimet për mallra dhe shërbime, që afërsisht arrijnë shifrën prej 40% të totalit të buxhetit të agjencisë, pasi që nuk janë prezantuar të dhëna më detale për këto shpenzime në raport?

**Bedri Mecini** sa i përket shpenzimeve për mallra dhe shërbime, ato janë realizuara 81 % e planifikimit të kësaj kategorie dhe një masë të madhe ka të bëjë me shpenzimet për qira dhe pagat që kanë marrë anëtarët e Këshillit. Mund të ofrohet raport plotësues për të dhëna më detale për këto shpenzime.

**Safete Hadërgjonaj** theksoi se pjesa financiare e raportit nuk është prezantuar siç kërkohet, do të duhej të prezantoheshin të dhëna më të detalizuara për shpenzimet, dhe kërkoi që në të ardhmen të

përmisohet kjo praktikë e raportimit. Më pas pyeti pse me rastin e furnizimeve, pjesa më e madhe e tyre është bërë me procedurë të negociuar, qfarë është blerë përmes kësaj procedure?, kur dihet fakti se ne nga raportet tjera kemi qenë kritikë lidhur me aplikimin e kësaj procedure. Një çështje tjetër shqetësuese ka të bëjë mos realizimin e mjeteve të ndara për rrezikshmëri, në këtë drejtim është dashur që agjencia të bëjë një analizë të arsyeshme dhe të klasifikohen punëtorët që i'u nënshtrohen rrezikshmërisë dhe të shpenzohen mjetet e aprovuara për këtë qëllim dhe mos të pësojnë ata që i'u takojnë këto mjete, për shkak të tjerëve që nuk i'u takojnë.

**Kryesuesi** gjithashtu iu bashkëngjiti vërejtjeve për formën e hartimit të raportit dhe se këso vërejtje ka pasur edhe vitin e kaluar. Kërkoj që në vitet në vazhdim pjesa financiare e raporti të jetë më e detalizuar dhe të hartohet sipas formularëve standard.

**Naser Osmani** thekoi se çështje e rëndësishme që na intereson është çëshjta hetimeve të kryera gjatë vitit, pyeti cilat janë ato hetime, në cilat sektorë janë bërë dhe qfarë do të bëhet me ato? Në mungesë të drejtorit për të dhënë sqarimet e nevojshme, vlerësoi të parëndësishme diskutimin në Komision dhe propozoi që raporti t'i procedohet Kryesisë së Kuvendit, që i njëjti të radhitet për diskutim në seancën plenare.

**Haki Shatri** njoftoi se radhitja në rend dite e këtij raporti në KMFP nuk është bërë për të diskutuar pjesën financiare, por pjesa përmbajtësore që lidhet me keqpërdorimin e parasë publike. Nga diskutimi raportit nga në atë komisioni është vlerësuar se dukuria e korrupsionit është në rritje për 40 % dhe disa deputetët që kanë sabotuar mbledhjen e atij komisioni, tregojnë se nuk ka vullnet politikë për të luftuar atë.

**Hajdin Abazi** pasi që nga të dhënat në shtyp është thënë se është rritur niveli i korrupsionit, pyeti a tregon kjo se është rritur efikasiteti i juaj në luftën kundër korrupsionit apo janë informacione për rastet që nëse vërtetohen, tregojnë se është rritur korrupsioni në institucionet tona?

**Safete Hadërgjonaj** vlerësoi një akuzë të rëndë komentet e kryetarit të KMFP. Theksoi se është e paarsyeshme dhe e panevojshme të thuhet se nuk keni treguar gatishmëri për të luftuar korrupsionin. Nuk e kemi sabotuar mbledhjen dhe nuk jemi pengesë e mbledhjeve, përkundrazi të interesuar që të luftohet dukuria e korrupsionit. Por një duhet të jetë e qartë, nuk duhet ulur rëndësia dhe vlera që ka komisioni në mbikëqyerjen e shpenzimit të parasë publike. T'i lëmë akuzat dhe të punojmë me efikasitet në të ardhmen.

**Kryesuesi** theksoi se duhet shikuar nivelin e korrupsionit dhe rasteve të dyshuara sipas viteve. Nga raporti shifet se në vitin 2009 kemi më shumë raste të raportuara, por që shumica e këtyre rasteve të raportuara kanë të bëjë me vitet e kaluara. Kjo nënkupton se kemi të bëjë me një dukuri të keqe që ka lindur që nga fillimi, me një fenomen që duhet luftuar nga të gjithë.

**Mentor Borovci** njoftoi se në raport në këtë vit për dallim nga viti kaluar janë raportuar më shumë raste, por ne nuk marrim përgjegjësi të themi se është rritur apo zvogëluar korrupsioni, pasi që agjencia nuk disponon mekanizma të këtilla për ta matur korrupsionin.

**Suzana Novobërdaliu** vlerësoi raportin të mirë i cili do të jetë edhe objekt diskutimi në seancë. Pasiqë po diskutojmë pjesën financiare, konsideroi të parëndësishme që agjencioni të qëndrojë në një objekt me qira dhe në këtë drejtim ne duhet bërë përpjekje për të zgjidhur këtë çëshjte duhet t'iu bëjmë zgjidhje.

**Besa Gaxherri** theksoi se edhe vetë korrupsioni paraqet implikime buxhetore dhe si komision për buxhet dhe financa nuk duhet kufizuar vetëm në anën financiare të raporteve. Nuk pajtohet me konstatimet e përfaqësuesve të agjencionit që për shkak të presioneve politike nuk thonë se nuk ka rritje të korrupsionit. Nga raporti shifet se janë paraqitur rastet e dyshuara dhe raportuar, ndërsa është dashur që të paraqiten emrat e ministrive dhe agjencive, që dyshohen për korrupsion. Është dashur që drejtori të ishte i pranishëm për të dhënë sqarime të nevojshme lidhur me këtë raport.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

#### **REKOMANDIM**

- I. Raporti i Agjencisë Kosovare të Korrupsionit për vitin 2009, procedohet për shqyrtim në seancën plenare të Kuvendit.

#### **5. Shqyrtimi i Projektligjit për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare me raportin me amendamente të komisionit funksional - Komisioni për Punë të Jashtme, me amendamente**

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

#### **REKOMANDIM**

- I. Projektligji për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare nuk përmban implikime buxhetore.
- II. Raporti me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Jashtme nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

#### **6. Shqyrtimi i Projektligjit për Gazetën Zyrtare me raportin me amendamente të komisionit funksional -Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente**

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

#### **REKOMANDIM**

- I. Projektligji për Gazetën Zyrtare nuk përmban implikime buxhetore.
- II. Raporti me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

#### **7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar**

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## REKOMANDIM

I. I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, pa ndryshime.

### **8. Informatë në lidhje me propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndryshimin e tabelave buxhetore 3.2 dhe 4.2 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010**

**Haki Shatri** theksoi se informata i plotëson kushtet e parapara në nenin 7.2., por e njëjta nuk i plotëson kushtet e parapara në nenin 7.1. Brengat e mija të paraqitura lidhur me shumën prej 148 milion eurove të paraqitura me rastin e shqyrtimit të buxhetit, nuk janë prezantuar në këtë informatë. Gjithashtu edhe informata nuk është prezantuar me kohë siç e thotë ligji brenda 30 ditësh, nga miratimi i buxhetit.

**Naser Osmani** lidhur me informatën, theksoi se mund të kërkohet një raport plotësues konform nenit 7.

**Kryesuesi** njoftoi se çështjet e ngritura nga z. Shatri kanë përgjigje nga zv. Ministri gjatë fazës së shqyrtimit të buxhetit. Komisioni mund të kërkohet që informata të plotësohet sipas nenit 7.1.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni nxori këtë:

## PËRFUNDIM

- I. Komisioni vlerësoi se informata për ndryshimin e tabelave buxhetore 3.2 dhe 4.2 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010 është e pjesshme dhe plotëson vetëm kushtet ligjore të rregulluara me neni 7.2. të Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010.
- II. Kërkohet nga Qeveria të plotësojë informatën për ndryshimin e tabelave buxhetore 3.2 dhe 4.2 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, siç rregullohet me nenin 7.1. të Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010.

### **9. Të ndryshme.**

#### **9.1. Plotësimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për Financimin e Subjekteve Politike në Kosovë**

**Kryesuesi** më qëllim të procedimit më të shpejtë të Projektligjit kërkohet që të plotësohet grupi punues. Përveç anëtarëve aktual z. Gani Koci, znj. Kosara Nikolic, z. Haki Shatri dhe z. Armend Zemaj, propozoi që pjesë e këtij grupi të jenë edhe z. Naser Osmani, znj. Suzana Novobërdaliu dhe z. Hajdin Abazi.

**Haki Shatri** njoftoi se për shkak të angazhimeve shtesë në dy javët e ardhshme dhe për arsye se grupi parlamentar ka vendosur që sjellë dikën tjetër në vend timin në këtë komision, nuk mund të jetë më pjesë e punimeve të grupit punues.

Pas diskutimeve dhe propozimeve për plotësimin e grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për Financimin e Subjekteve Politike në Kosovë, u vendos që pjesë e grupi të jenë këta anëtar: **z. Gani Koci, z. Naser Osmani, znj. Kosara Nikolic, z. Armend Zemaj, znj. Suzana Novobërdaliu dhe z. Hajdin Abazi.**

## 9.2. Shqyrtimi i KASH-it të Kuvendit të Kosovës për vitin 2011 – 2013

**Kryesuesi** njoftoi se kemi një kërkesë nga sekretari i Kuvendit që Komisioni të jap një rekomandim sa i përket Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit 2011-2013.

**Ismet Krasniqi** njoftoi se konform Rregullores së punës së Kuvendit kemi procedura në këtë komision KASH-in e Kuvendit 2010-2012, e cila parasheh planifikimet buxhetore të Kuvendit për periudhën afatmesme. Ndër tjera janë planifikuar mjetet për qendrën protokollare “Villa Gërmija”, pagat për deputetët pasiv, për rritje e numrit të stafit të administratës, stafin mbështetës politik, për hapjen e zyreve në Kuvendet Komunale. Ndërsa jemi në fazën e hartimit të planit ideor për renovimin e aneksit të ndërtesës së Kuvendit.

**Naser Osmani** pyeti se qfarë ka ndodhur me procesin gjyqësor për qendrën “Villa Gërmija”?

**Ismet Krasniqi** në përgjigjen e parafolësit, njoftoi se për rastin “Villa Gërmija”, gjykata na ka kthyer lëndën mbrapa me arsyetimin se nuk mund të jemi palë kontraktuese, ndërkaq për rastin e veturës e ka shpallur në vendimin në favor tonin duke na njohur si palë kontraktuese. Ministria e Drejtësisë ka ngritur një divizion për përfaqësimin e institucioneve në gjykata dhe lëndë është dërguar në këtë divizion dhe ajo është në procedurë.

**Kryesuesi** kërkoi që komisioni të jap një mbështetje kësaj kërkesë, dhe më pas me rastin e shqyrtimit të KASH-it, do të trajtohet më hollësisht buxheti i Kuvendit për periudhën afatmesme.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me nëntë vota Për, një Abstenim (znj. Besa Gaxherri) dhe asnjë Kundër nxori këtë:

### REKOMANDIM

- I. I rekomandon Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, që të miratojë Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2011-2013.
- II. Komisioni kërkon nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës, t’i rekomandojë Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, që projeksionet buxhetore afatmesme të Kuvendit të Kosovës, të përfshihen në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2011-2013.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

**Përgatitur nga:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryesues i Komisionit  
Gani Koci**

---